



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seancë plenare e Kuvendit

P- 015

Prishtinë, më 17 prill 2008, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala e seancave plenare.

PROCESVERBAL

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË
17 PRILL 2008

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Eqrem Kryeziu**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 97 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6 pika 2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Ndërkohë, askush sipas rregullës 23.2 nuk ka parashtruar kërkesë me shkrim për ta ndryshuar apo plotësuar rendin e ditës.

Ai propozoi të procedohet sipas rendit të ditës.

Deputeti **Berat Luzha** propozoi që në seancën e sotme të futet edhe një pikë e rendit të ditës – nxjerrja e një deklarate kundër akuzave të Carla del Ponte, që e ka bërë ndaj UÇK-së.

Deputeti **Fatmir Rexhepi** propozoi që në seancën e sotme të futet edhe një pikë e rendit të ditës – nxjerrja e një deklarate kundër mbajtjes së zgjedhjeve të Serbisë, më 11 maj, në Kosovë.

Deputeti **Lulzim Zeneli**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, e mbështeti propozimin e deputetit Rexhepi.

Deputeti **Gani Koci** propozoi që në seancën e sotme të shqyrtohet edhe pika e pambaruar nga seanca plenare e datës 14 mars 2008 - shqyrtimi i Raportit të Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik dhe emërimi i anëtarëve të Këshillit të Agjencisë Kundër Korrupsionit..

Kryetari tha se propozimet e deputetëve duhet të parashtrohen me shkrim, sipas rregullave të procedurës së Kuvendit.

Kuvendi i vazhdoi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave të mëparshme,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sponsorizimet në kulturë, rini dhe sporte,
4. Shqyrtimi parë i Projektligjit për Ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblët e tjera,
5. Shqyrtimi parë i Projektligjit për ndërmjetësim, dhe
6. Shqyrtimi i propozimit të Grupit Parlamentar të SLS-së për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për Punë Jashtme.

1. Miratimi i procesverbaleve nga seancat plenare të mbajtura më 4 dhe 9 prill 2008

Kryetari sqaroi se me rastin e miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, më 9 prill 2008, kur deputetët janë ngritur në këmbë, nuk i ka parë të gjithë dhe ka konstatuar se me aklamacion 107 deputetë kanë votuar “për”. Ndërkohë, në Ueb-faqen e Kuvendit në Internet janë dhënë sqarime se 4 deputetë nuk kanë marrë pjesë në votim.

Ai kërkoi nga deputetët, që donë ta deklarojnë votën e tyre “për”, “kundër” ose abstenim dhe të regjistrohet në procesverbal, sepse kjo, në fund të fundit, mund të korrigjohet në procesverbal.

Deputetët: **Besa Gaxheri, Numan Baliq, Melihate Tërmkolli, Driton Tali dhe Adem Salihaj** bënë vërejtje për mënyrën e procedimit të miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Vërejtjet e tyre janë dhënë në transkript.

Kryetari hodhi në votim miratimin e procesverbaleve të 4 dhe 9 prillit 2008. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----shumica absolute,
Kundër-----3,
Abstenime-----9.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 4 dhe 9 prill 2008.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Driton Tali** i parashtroi pyetje Qeverisë lidhur me fillimin e ndërtimit të 70 shtëpive dhe 20 banesave për serbë të kthyer në fshatin Badovc.

Zëvendëskryeministri **Ramë Manaj** iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputeti **Gani Geci** i parashtroi pyetje ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit lidhur me pagesën e borxhit të PDK-së ndaj Postës për telefoni.

Ministri **Fatmir Limaj** iu përgjigj pyetjes së deputetit Geci.

Deputeti **Naser Rugova** i parashtroi pyetje ministrit të Shëndetësisë lidhur me ndërprerjen e energjisë elektrike në Qendrën Klinike Universitare.

Ministri **Alush Gashi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Rugova.

Deputeti **Ibrahim Makolli** i parashtroi pyetje ministres së Drejtësisë lidhur me kërkesën e të burgosurve në Burgun e Dubravës për amnisti nga ana e Presidentit të Kosovës.

Zëvendëskryeministri **Ramë Manaj** iu përgjigj pyetjes së deputetit Makolli.

Deputetja **Myzejene Selmanaj** i parashtroi pyetje Kryeministrit lidhur me masat e ndërmarra nga ana e Qeverisë për furnizimin e rregullt me energji elektrike.

Zëvendëskryeministri **Hajredin Kuçi** iu përgjigj pyetjes së deputetes Selmanaj.

Deputetja **Rita Hajzeraj** i parashtroi pyetje ministrit të Ekonomisë dhe të Financave lidhur me ngritjen e çmimeve për mallra dhe shërbime, kurse pagat e të punësuarve mbesin fikse.

Ministri **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetes Hajzeraj.

Deputetja **Gjylnaze Sylja** i parashtroi pyetje ministrit të Shëndetësisë lidhur me formimin e një sistemi të integruar të informimit shëndetësor në nivel vendi.

Ministri **Alush Gashi** iu përgjigj pyetjes së deputetes Sylja..

Deputeti **Hajdin Abazi** i parashtoi pyetje ministrit të Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor lidhur me masat e kësaj ministrie për ruajtjen e bifurkacionit në komunën e Ferizajt.

Ministri **Mahir Yagcilar** iu përgjigj pyetjes së deputetit Abazi.

Deputeti **Naser Rugova** i parashtoi pyetje ministrit të Shëndetësisë lidhur me zgjedhjen e asistentëve në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës.

Ministri **Alush Gashi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Rugova.

Deputeti **Hajredin Hyseni** i parashtoi pyetje ministres së Drejtësisë lidhur me Projektin e Shoqatës së të Burgosurve dhe të Mbijetuarve në burgun e Dubravës gjatë vitit 1999 për të ndërtuar një Pllakë Përkujtimore në shenjë nderimi dhe përkujtimi të atyre që u vranë në këtë burg nga forcat serbe.

Zëvendëskryeministri **Ramë Manaj** iu përgjigj pyetjes së deputetit Hyseni.

Deputeti **Riza Smaka** i parashtoi pyetje Kryeministrit të Kosovës lidhur organizimin dhe funksionimin e Trustit të Kursimeve të Pensioneve.

Zëvendëskryeministri **Hajredin Kuçi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Pyetjet që nuk morën përgjigje në seancën e sotme, ngase nuk premtoi koha (50 minuta), mbeten për të marrë përgjigje në seancën e radhës.

Në vazhdim, seancën e kryesoi **Eqrem Kryeziu**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Sponsorizimet në kulturë, rini dhe sport

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta prezantojë Projektligjin për sponsorizimet në kulturë, rini dhe sport.

Zëvendësministrja, **Lirije Kajtazi**, gjatë prezantimit të Projektligjit tha se qëllimi i Projektligjit për sponsorizime në kulturë, rini dhe sport është rregullimi juridik i veprimtarive sponzoruese, si dhe përcaktimi i përgjegjësisë të bartësve në menaxhimin me te, veprimtaritë e interesit publik dhe mbështetjen institucionale në realizimin e programeve të zhvillimit të aktiviteteve kulturore, sportive e rinore, qoftë në interes të përgjithshëm, qoftë edhe ato të interesit lokal.

Projektligji përcakton përkufizimet themelore të nocioneve në përputhje me parimet dhe standardet ndërkombëtare të sponzorimeve, zhvillimin e sponzorimeve për të gjithë dhe institucionalizimin e këtij aktiviteti. Gjithashtu, përcakton edhe procedurat dhe kriteret për sponzorim, marrëdhëniet sponzoruese, raportin e komunitetit biznesor përgjegjës për sponzorime dhe të organizatave të tjera sponzoruese, etj.

Rregullimi i shumë çështjeve me rëndësi praktike për aktivitetin sponzorues, e që ka të bëjë me zbatimin e dispozitave të ndryshme të Projektligjit, do të bëhet me akte nënligjore, që është praktikë e zakonshme legislative.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për sponsorizimet në kulturë, rini dhe sport,

Opinione, vërejtje dhe sugjerime në Projektligjin për sponsorizimet në kulturë, rini dhe sport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Memli Krasniqi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Adem Hajdaraj**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Esat Brajshori**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Rasim Selmanaj**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Drita Maliqi**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Enis Kervan** dhe në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, **Bojan Stojanoviq**, si dhe deputetët **Emrush Xhemali**, **Hydajet Hyseni**, **Sabri Hamiti**, **Armend Zemaj**, **Riza Smaka** dhe **Naim Rrustemi**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 67;

Kundër-----3;

Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi në parim Projektligjin për sponsorizime në kulturë, rini dhe sport.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion e Gjyqësi, Komisionin për Buxhet e Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropiane, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

4. Shqyrtimi parë i Projektligjit për Ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet e tjera,

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta prezantojë Projektligjin për Ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet e tjera.

Zëvendësministrja, **Lirije Kajtazi**, gjatë prezantimit të Projektligjit tha se nevoja që të rregullohet vazhdimësia, organizimi, veprimtaria dhe funksionimi i Ansamblit të këngëve dhe valleve “Shota” ka bërë që të përgatitet ky Projektligji.

Me këtë Projektligj në mënyrë të qartë, sistematike dhe të bashkërenditur është normuar statusi juridik i Ansamblit kombëtarë të këngëve dhe valleve “Shota”, themelimi përkatësisht vazhdimi i punës dhe veprimtarisë së tij, rregullimi dhe organizimi i brendshëm i ansamblit, udhëheqja, drejtimi, statusi dhe të drejtat e punëtorëve.

Me këtë Projektligj përcaktohen parimet dhe rregullat themelore mbi krijimin e këtij Ansambli, po ashtu përcaktohen detyrimet dhe përgjegjësitë e institucionit për sigurimin e kushteve, të masave për mbrojtjen, zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e këtij institucioni. Projektligji ka parapa edhe krijimin e Bordit Drejtues si dhe të Këshillit Artistik të Ansamblit me qëllim të një menaxhimi më të mirë.

Në fund, Zëvendësministrja, **Lirije Kajtazi**, ftoi deputetët që ta miratojnë, në parim, këtë projektligj.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për Ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet e tjera.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime në Projektligjin për Ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet e tjera dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Drita Badivuku**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Fatime Berisha**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Esat Brajshori**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Naim Maloku**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Naser Rugova**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Shpresa Murati** dhe në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, **Bojan Stojanovic**, si dhe deputetët: **Sabri Hamiti**, **Hydajet Hyseni**, **Riza Smaka**, **Armend Zemaj**, **Adem Hajdaraj**, **Bojan Stojanovic** dhe **Bujar Bukoshi**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 51;
Kundër----- 1.
Abstenime-----10.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi në parim Projektligjin për Ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet e tjera.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet e Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligji brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi parë i Projektligjit për ndërmjetësim

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta prezantojë Projektligjin për Ndërmjetësim.

Zëvendëskryeministri, **Ramë Manaj**, gjatë prezantimit të Projektligjit tha se ky projektligji do t’i eliminojë zbrazësitë ligjore në lëmin e ndërmjetësimit, në anën tjetër do të mundësojë shtimin e efikasitetit të punës së gjykatave dhe të prokurorive, thjeshtësimin dhe përshpejtimin e procedurave, si dhe uljen e shpenzimeve procedurale.

Qëllimi kryesor i projektligjit për ndërmjetësimin është rregullimi i procedurës së ndërmjetësimit në përgjithësi; themelimi, organizimi dhe funksionimi i Komisionit të Ndërmjetësimit; si dhe të drejtat, detyrat dhe përgjegjësit e ndërmjetësuesve.

Ky projektligji ka shtatë kapituj me gjithsej 29 nene dhe përcakton rregullat e procedurës së ndërmjetësimit në marrëdhëniet kontestuese, posaçërisht në raportet juridiko - pasurore të subjekteve, të drejtën tregtare, familjare, të punës, raporte të tjera civile, administrative dhe penale, në të cilat palët munden lirisht të disponojnë me vullnet të lirë, po që se nuk është paraparë përgjegjësia ekskluzive e gjykatës apo e një organi tjetër kompetent.

Zëvendëskryeministri, **Ramë Manaj**, ftoi deputetët ta miratojnë, në parim, këtë projektligj.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Projektligjit për ndërmjetësimin, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime në Projektligjin për ndërmjetësimin dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Nerxhivane Dauti**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Kolë Berisha**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Riza Smaka**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Bajram Kosumi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Adem Salihaj**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Xhezair Murati** dhe në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, **Kosara Nikoliq** si dhe deputetët: **Bahri Hyseni dhe Suzana Novobrdaliu**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 56;

Kundër----- 3.

Abstenime-----5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi në parim Projektligjin për ndërmjetësimin.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Buxhet e Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligji brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i propozimit të grupit Parlamentar të SLS-ës për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për Punë të Jashtme

Kryesuesi i informoi deputetët se deputeti Dragisha Mirić është tërhequr nga Grupi Parlamentar i SLS-së, kryetari i këtij grupit ka kërkuar nga Kuvendi, në pajtim me Rregullën 48 të Rregullores së Punës, zëvendësimin e tij, i cili është anëtar aktual i Komisionit për Punë të Jashtme, me deputeten Radmila Vujović.

Kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij propozimi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 57;

Kundër----- 1.

Abstenime-----2 .

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash mori këtë

V E N D I M

1. Deputetja **Radmila Vujović** zgjedhet anëtare e Komisionit për Punë Jashtme, në vend të deputetit Dragisha Mirić.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën në orën 13:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale